



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-7108 dt. 19/02/ 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Bekim Lestrani, më datë: 28.02.2025 (E premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 31.01.2025.
2. Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
4. Të ndryshme.

Drenas, 19.02.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Bekim Lestrani
Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-6993 dt. 19/02/ 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 31.01.2025, duke filluar në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Egzona Qorri (LDK), Mergim Pirraku (DD).

Munguan: Beqir Kiqina (AAK), Labinot Halilaj (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Mergim Pirraku (DD), Muhamet Kurtaj VV.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive.
Prezent ishin 18 anëtarë të Kuvendit Komunal.

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt. 30.12.2024;
2. Propozim-vendimi për ndryshim-plotësimin e Rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba;
3. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit me nr.02-400/01-57008, dt. 29.11.2024 për miratimin e Raportit të komisioneve komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
4. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale për vitin 2024;
5. Raporti financiar janar-dhjetor 2024;
6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me pikën shtesë dhe rendi i ditës kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit më 31.12.2024, pasi nuk pati vërejtje as diskutime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e parë me **17 vota** "Për", Kundër "0", Abstenim "1", kaloi edhe pika e parë e rëndit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2. Propozim-vendimi për ndryshim-plotësimin e Rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Egzona Terdevci, tha se 30 ditë kohë pas pranimit të faturës, por edhe pagesa është 30 ditë kohë e jo brenda vitit fiskal siç ka qenë në fillim, për mua është pak paradoksale 30 ditë afati i pagesave dhe 30 ditë afati i ankesave, pra qysh mundet brenda 30 dite me paguar edhe me ankuar nuk ka sens është dashtë me e lënë 30 ditë afatin e ankesave, kurse 45 ditë afatin e pagesave. Ne si asamblistë kemi pranuar shumë ankesa prej bizneseve për taksën që e konsiderojnë të pa drejtë afati i pagesave ishte dashtë me qenë brenda vitit fiskal jo brenda 30 ditëve këtë pjesë. Kisha dashtë me ndryshuar dhe është një paradoks të kodet e reja që janë shtuar marrja me qira dhe dhënia e lizingut pajisjeve të transportit ujorë është 150 euro. Është edhe marrja me qira e lizingut dhe pajisjeve të transportit, sallonet e floktarisë e kanë 200 euro e kanë ngarkesën, për mua është paradoksale që do biznese shumë të vogla me pas taksa më të mëdha, kurse bizneset e transportit ajror edhe pse e di që nuk ka në Drenas me pas taksë më të lirë.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, tha se për pikën e parë shumë e cili më pak sepse raportet e fund vitit për çdo biznes evidentohen kush ka qarkullim më shumë kush më pak.

Violeta Baleci, përshëndetje për të gjithë. Sa i përket pikës 13.2.8 dua të ju sqaroj afatin që e kontestuat me herët 30 ditësh është për dy arsye. Në momentin që ti e faturon ofertën automatikisht programi ta faturon afatin e pagesës 30 ditë dhe afati për ankesa sipas ligjit të procedurës administrative është 30 ditë.

Sa i përket programit të taksës jemi në procedurë për me i bërë disa modifikime edhe me angazhuar një operator në mirëmbajtje të programit, po për derisa ajo është në procedurë mundemi me thënë që për momentin është 30 ditë, ligji thotë që prej 30 ditësh e andej mundesh me dërguar në procedurë përmbartimore.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e dytë me **23 vota** "Për", Kundër "2", Abstenim "0", kaloi edhe pika e dytë e rëndit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr.02-400/01-57008, më 29.11.2024 për miratimin e Raportit të komisioneve komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Egzona Terdevci, tha se në nëntor na keni sjell shumën 251,874,00 mijë euro, në janar ka ardhur shuma 215,304.87 euro, por shuma reale është 206,776,91 euro. Unë kam kërkuar qasje në dokumente publike e kam marrë raportin e dëmeve janë tri raporte prej tri komisioneve të

ndryshme nëse i mbledhë këto tri totale përveç nëse keni gabuar të totali shuma del 206,772.91 euro, vetëm dua të dimë a e keni kalkuluar mirë shumën se me gjasë duhet me u ndryshuar prapë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Bujqësisë Anita Avdullahu, tha se sipas informatave që kam nga komisioni vetëm të shuma përfundimtare është bërë një gabim teknik dhe për atë arsye e kemi sjellë që të duhen diçka informata shtesë mundesh me u drejtuar edhe të komisioni.

Pasi nuk pati vërejtje as diskutime. **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën tre me 22 vota” Për”, Kundër ”0”, Abstenim”0”, kaloi edhe pika e tretë e rëndit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale për vitin 2024. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kalojmë te pika e radhës, sepse raportet nuk votohen.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 5. **Raporti financiar janar-dhjetor 2024.**

Egzona Terdevci, unë i kam dy pyetje të raporti financiar të hyrat nga kodi 66310, shitja e pasurisë publike në tre mujorin e tretë kur është prezantuar raporti për shtator ka qenë 15,000,119,21 euro, tash për tërë vitin 6271 s’po kuptoj a keni bërë gabim diçka dhe në raport asnjëherë nuk po përfshihen llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, a bënë me ditë edhe në si asamblist sa ka borxh Komuna e Drenasit dhe sa kanë borxhe të tjerët ndaj Komunes.

Drejtoresha e Drejtorisë së Financave Albulena Saliuku, përhëndetje për të gjithë, sa i përket kodit që e parashtroi pyetjen znj. Terdevci, këtë kod veç se e kemi sqaruar në seancën e kaluar dhe të gjitha informatat i keni në formë tabelare dhe në formë të shkruar.

Egzona Terdevci, unë nuk kërkoja sqarim për kodin se çka bëhet fjalë, po qysh mundet për 9 muaj me kanë shuma më e madhe se për tërë vitin, a ka mundësi me ditë se qysh për 9 muaj janë 15 mijë euro të hyra, ndërsa për krejt vitin 6271 të hyra.

Zyrtari kryesor financiar Kushtrim Bajraktari, e nderuar edhe në seancën paraprake është sqaruar që është bërë një gabim teknik të faturimi edhe ajo pjesë e të hyrave ka pasur të bëjë me Drejtorinë e Urbanizmit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, vazhdojmë me pikën e radhës, sepse raportet nuk votohen.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Kryesuesja e Komitetit Antigona Bucolli, paraqet Raportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në pika të shkurtra.

Kryesuesja e Komitetit Antigona Bucolli, përhëndetje për të gjithë, dua të them se Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit, publikon këtë raport vjetor, me qëllim që të mbajmë të informuar të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit lidhur me punën dhe aktivitetet e realizuara dhe mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2024.

Ky organ drejtues institucional i formuar për herë të dytë në Komunën e Drenasit, si qëllim prioritar i këtij komiteti është të sigurojë përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke nxitur dhe siguruar mundësinë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Drenasit t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, vazhdojmë me pikën e radhës, sepse raportet nuk votohen.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 7.


Të ndryshme.

Pasi nuk pati vërejtje, diskutime dhe sugjerime mbledhja përfundoi në ora 11:40.

Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 31.01.2025 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.

<https://ëëë.facebook.com/komunadrenas/videos/2502095836805312>

Procesmbajtësja



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-030/01-6587 dt. 13/02/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3,4 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi:

PROPOZIM VENDIM

Për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si në vijim:

Z. Drin Halilaj, zëvendësohet me znj. Marigona Bazaj, Kryesuese e Komitetit për Komunitete

Znj. Donika Zogu, zëvendësohet me znj. Anita Curri, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKS-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të zëvendësuar është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Ndërsa, zëvendësimi i anëtarit të KKSB-së është paraparë me nenin 15 të ligjit të njëjtë.

Meqenëse Drini Halilaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e asamblistit, i cili ka qenë edhe kryesues i komitetit për komunitete, anëtar i KKSB-së, pas mbledhjes së këtij komiteti me datë 05.2.2025 kryesuese është zgjedhur Marigona Bazaj. Gjithashtu, pas dorëheqjes së Donika Zogut nga pozita e udhëheqëses së KVRL-së, Anita Curri e zëvendëson dhe ushtron këtë pozitë. Sipas nenit 15 të udhëzimit të njëjtë, propozohet miratimi i plotësim-ndryshimit të vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi me numër të protokolit 12-030-65514, dt 23.12.2021.



Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM



Drenas, nr. 01-052/01-6010
Dt. 10/02/2025

DATA:	
REFERENCA:	Raporti Vjetor i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024
PËR:	z. Bekim Lestrani – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES:	z. Ramiz Lladrovci – Kryetar i Komunës së Drenasit 
KOPJE:	z. Arben Shala – Nënkryetar i Komunës së Drenasit z. Skender Berisha – Shef i Kabinetit të Zyres së Kryetarit
NGA:	Kamer Ramaj – Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit. 
LËNDA:	Raport i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 dhe Plan i implementimit të rekomandimeve.

Përmes kësaj shkrese, në formë të përmbledhur po ju përcjellim Raportin e punës dhe angazhimeve të kapaciteteve audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit si dhe Planin e implementimit të rekomandimeve për vitin 2024.

RAPORT VJETOR I PUNËS SË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM TË KOMUNËS SË DRENASIT SI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE PËR VITIN 2024

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT.

Auditimi i brendshëm është aktivitet i pavarur , aktivitet me siguri të arsyeshme, objektive , dhe konsultativ, i përcaktuar që të shtoj vlerat dhe të përmirësoj funksionet e organizatës. Ky aktivitet ndihmon menaxhmentin në rritjen e vlerës dhe në vendimmarrje.

Ai ndihmon organizatën që të përmbushë objektivat e saja duke paraqitur një qasje sistematike, profesionale dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe vendimmarrjes.

Auditimi i brendshëm është një funksion vlerësues i pavarur i cili mbledh, klasifikon, vlerëson dhe raporton të dhënat duke i ofruar menaxhmentit një siguri të arsyeshme dhe të besueshme se në çfarë masë janë duke u përmbushur objektivat e sistemit dhe në çfarë shkalle të rrezikut gjendet ai sistem nga keqinterpretimet, keqmenaxhimet, keqdeklarimet, shpërdorimet, mashtrimet , humbjet etj.

Në pajtim me Ligjin 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike është hartuar dhe miratuar Plan Strategjik i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitet 2024-2026, ku janë paraparë Objektivat kryesore për një cikël trevjeçar të auditimeve, si dhe në pajtim me këtë plan është hartuar edhe Plan Vjetor i angazhimit të kapaciteteve audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024. Plan Strategjik dhe Plan Vjetor janë aprovuar paraprakisht nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit sipas kërkesave të Ligjit nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Këto Plane janë hartuar duke u bazuar në vlerësimin e rregullt vjetor të rrezikut për të gjitha fushat që përbëjnë universin e auditimit në Komunën tonë. Pas vlerësimit të shkallës së rrezikut për secilën fushë të identifikuar, është bërë rangimi i detyrave të punës audituese duke u bazuar në kapacitetet audituese ekzistuese në komunën tonë. Këto Plane Strategjike dhe Vjetore pasi që janë aprovuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, janë dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm .

Pas aprovimit të këtyre dy planeve, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka filluar me auditimet e parapara për vitin 2024 sipas orarit të paraqitur në Planin Vjetor.

Me këto plane të punës janë planifikuar tri tipe të auditimeve si: auditimet preventive (parandaluese), auditimet detektive (zbuluese), dhe auditimet direktive (nxitëse).

Gjatë vitit 2024 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë realizuar të tria tipet e auditimeve sipas planit të punës.

Auditimet dhe rekomandimet preventive kishin për qëllim parandalimin e ngjarjeve të pa dëshirueshme dhe kanë të bëjnë me këshillimet e menaxhmentit gjatë vendimmarrjes. Në këtë grup hynë edhe shërbimet këshilldhënëse dhe të konsulencës që stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm i ka planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës që mbulohet nga ky raport i punës.

Auditimet detektive ishin auditime zbuluese (ex- post) dhe zakonisht kanë përfunduar me një numër të caktuar të rekomandimeve për vëmendje për menaxhmentin.

Auditimet dhe rekomandimet direktive kishin për qëllim për të shkaktuar dhe inkurajuar ndodhjen e ngjarjeve të dëshirueshme.

Pas aprovimit të Planit Strategjik dhe Planit të punës, angazhimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2024 ka pasur për qëllim realizimin e auditimeve të planifikuara për këtë vit, si dhe kryerjen e rishiqimeve për auditimet e kryera sipas Planit të veprimit të prannar nga menaxherët e drejtorateve ku ishte kryer auditimi. sipas kërkesave të formularit standard 4001 në lidhje me progresin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna . Në lidhje me këtë, dy here brenda vitit 2024 është hartuar Raport nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ku është paraqitur shkalla e implementimit të rekomandimeve të dhëna. Këto Raporte janë diskutuar së bashku me Kryetarin në mbledhjet e rregullta të Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Në vitin 2024, sipas planit vjetor të angazhimit të kapaciteteve audituese ishin paraparë të kryheshin gjithësej 7 (shtatë) auditime për dhënjë të sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore - Komunën e Drenasit.

Çdo auditim i kryer ka përfunduar me një Raport të shkruar i cili është shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si dhe në baza mujore është raportuar edhe në Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Poashtu, gjatë kryerjes së auditimeve të rregullta vjetore nga ana e Zyres Kombëtare të Auditimit, kësaj ju kanë dorëzuar edhe raportet tona.

Një vëmendje e caktuar i është kushtuar edhe vlerësimi vjetor të shkallës së rrezikut me të cilin afaron komuna si dhe në përgaditjen e Listes së rreziqeve komunale për vitin 2025.

Poashtu gjatë vitit 2024 stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka ndjekur edhe trajnimet e ofruara nga ana e Njesisë Qendrore Harmonizuese, USAID, DEMOS, etj për të realizuar Avancimin e Vazhdueshëm Profesional.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË VITIT 2024.

Plani vjetor i angazhimit të kapaciteteve audituese për vitin 2024 kishte paraparë të kryheshin 7 (shtatë) auditime të cilat janë kryer në tërësi dhe janë raportuar me raport me shkrim para Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Gjatë vitit 2024 janë kryer këto auditimet në këto fusha:

1. Auditimi i proqesit të menaxhimit me kontrata. Fushëveprimi i auditimit 01.01-31.12.2023.
2. Auditimi i proqesit të menaxhimit me pasuritë jofinanciare të Komunes . Fushëveprimi i auditimit: 01.01- 31.12.2023.
3. Auditimi i menaxhimit me resursat humane në sektorin e Administratës së Përgjithshme Komunale. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2023 – 31.03.2024.
4. Auditimi i proqeseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga Tatimi në Pronën e Pajuarshme. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2023 – 30.04.2024.
5. Auditimi i proqeseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga Taksat në biznes. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2024 – 30.06.2024.
6. Auditimi i proqesit të pagesave/shpenzimeve gjatë vitit 2024. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2024 -- 04.09.2024.
7. Auditimi i proqeseve të prokurimit gjatë vitit 2024. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2024 – 03.10.2024.

TË DHËNAT STATISTIKORE

Pas përfundimit të secilit auditim, menaxhmentit të audituar, Kryetarit të Komunes si dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm i është dorëzuar një Raport me shkrim mbi Auditimin e kryer. Raporti ka përmbajtur qëllimin e auditimit, objektivat e auditimit, rregullativen ligjore, gjendjen e konstatuar, shkakun, ndikimin dhe rekomandimet e propozuara në formë të sugjerimeve për përmirësimin të kontrollave aty ku ishte e nevojshme.

Rekomandimet e propozuara janë dhënë në atë mënyrë që të jenë lehtë të zbatueshme, të kenë kosto financiare të ulët, dhe të sigurojnë përmirësimin e kontrollave të brendshme ekzistuese në mënyrë që të mundësojnë arritjen e objektivave të përgjithshme të Komunes.

Gjatë vitit 2024 janë kryer shtatë auditime dhe janë dhënë gjithësej 58 rekomandime për shtimin dhe funksionalizimin e kontrollave të brendshme.

Siq është cekur edhe në pjesën e parë të këtij Raporti, Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2024 ka kryer edhe dy auditime për verifikimin e implementimeve të dhëna dhe ka raportuar dy here në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Gjatë verifikimit është konstatuar se nga numri i përgjithshëm i rekomandimeve të dhëna brenda vitit, 26 rekomandime ishin të implementuara tërësisht, 27 rekomandime ishin në proces të implementimit, dhe 5 rekomandime nuk kishin filluar ende implementimin. Rekomandimet e pazbatuara i takonin raportit të fundit të auditimit i cili ishte finalizuar vetëm disa ditë para se të bëhej vlerësimi, andaj nuk kanë mundur të implementoheshin në këtë fazë.

Rekomandimet e pa implementuara dori në periudhën gjashtëmujore, në të dhënat audituese do të evidentohen si detyra për gjashtëmujorin e ardhshëm, ndërsa ato të pa implementuara deri në fund të vitit kalendarik, do të mbosin në databazen e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për përkujdesje të vazhdueshme për implementimin e tyre në vitin në vazhdim.

Për të siguruar avancimin e vazhdueshëm profesional, auditorët e Njesisë së Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2024 kanë pasur edhe trajnime, seminare dhe tryeza pune të organizuara nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, USAID, DEMOS, etj.

Gjatë kësaj periudhe, me institucionet e përmendura janë mbajtur disa takime pune, tryeza dhe punëtori ku janë diskutuar tema nga sfidat e përgjithshme për avancimin e procesit të auditimit, vlerësimin e rreziqeve, hartimin e Planeve të auditimit, ritjen e shkallës së implementimit të rekomandimeve, auditimet e performancës, si dhe prezantimin e përmbushjes së kritereve të performancës.

TAKIMET E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.

Komuna e Drenasit ka të formuar Komitetin e Auditimit të Brendshëm që nga viti 2009 e këtej. Nga ky vit e tutje në vazhdimësi ky Komitet ka qenë aktiv dhe gjatë të gjitha viteve ka mbajtur takimet e rregullta të parapara me ligj.

Komiteli i Auditimit ka të hartuar edhe Statutin e vet dhe në këtë aspekt jemi komunë lidere sa i përket themelimit dhe funksionimit të Komitetit të Auditimit.

Anëtarët e Komitetit i përmbushin të gjitha kriteret ligjore të kërkuara me Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komiteteve të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik.

Gjatë vitit 2024 ky Komitet ka mbajtur katër takime të rregullta të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2019 ku ka diskutuar dhe aprovuar Planet e Njesisë së Auditimit, Raportet e auditimit, Raportimet gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe shkallën e implementimit të rekomandimeve.

Këto takime janë mbajtur sipas orarit të përcaktuar me këtë Udhëzim:

Takimi i parë është mbajtur me dt. 05.01.2024 ku janë shqyrtuar dhe aprovuar raporte të auditimit, Raporti i implementimit të rekomandimeve nga viti 2024, Raporti gjathtëmujor dhe vjetor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe Planit Strategjik dhe Planit vjetor i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Takimi i dytë është mbajtur me dt. 03.05.2024 ku janë shqyrtuar dhe aprovuar dy raporte të auditimit për auditimet e kryera nga ana e Njesisë së Auditimit.

Takimi i tretë është mbajtur me dt. 15.07.2024 ku janë shqyrtuar katër raporte të auditimit të kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Takimi i katërt është mbajtur me dt. 14.10.2023 ku janë shqyrtuar dhe aprovuar dy raporte të auditimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

SFIDAT, PROPOZIMET DHE REKOMANDIMET.

Proqesi i auditimit të brendshëm e përcjellin sfida të vazhdueshme të cilat kanë ndikim të lartë në sigurimin e ofrimit të shërbimeve të auditimit si dhe konsulentëve për menaxhmentin e institucionit. Standardet e auditimit që përdoren në Kosovë janë të marrura nga vendet që kanë një traditë shumë të gjatë të auditimit dhe kanë një stabilitet të nivelit të lartë. Në Kosovë, mjedisi i kontrollit është në nivel tjetër dhe ende është në proqes të krijimit dhe transformimit. Nisur nga ky fakt, është e natyrshme që Auditimi si proqes, e në veqanti Auditimi i brendshëm ende përballlet me sfida të caktuara si:

- Ndryshimi i shpeshtë i rregullatave ligjore dhe mosnjohimi me kohë me ndryshimet legjislative dhe Aplikimin e tyre brenda afateve sa më të shkurta.
- Mosharmonizimi dhe kompleksiteti i rregullatave ligjore dhe asaj nënligjore.
- Ndryshimet e shpeshta dhe pakjartësia e akteve ligjore dhe nënligjore.
- Ekzistimi i dykuptimësisë në rregullatave ligjore dhe rreziku nga aplikimi i gabueshëm i normave ligjore.
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit e në veqanti në fushat ku ka ndryshime të legjislativës dhe trajnimet për qasje në sistemin e Freco- Balancit.
- Mundësimi i trajnimeve përmes IKAL-it (trajnime me pagesë).
- Zhvillimi i auditimeve të performancës veqanërisht në disa prej fushave.
- Ushtrimi i mbikqyrjes së projekteve në mënyrë të vazhdueshme gjatë realizimit të tyre.
- Përgaditja e stafit alternativ për një numër të madh të funksioneve komunale për ushtrimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të përditshme komunale.
- Angazhimi më i madh në aktivitetet për implementimin e rekomandimeve të Auditorit.
- Përkrahja dhe fuqizimi i mëtutjeshëm i Komitetit të Auditimit.
- Përkrahja e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në proqesin e trajnimit.
- Kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm me gjithësej 3 auditorë.
- Angazhimi i menaxhmentit të lartë për jetësimin e rekomandimeve.
- Realizimi i Planit vjetor të Auditimit për vitin 2025.
- Realizimi i Planit strategjik të auditimit për tri vitet e ardhshme.
- Përmirësimi i kushteve të punës për Auditorë, dhe
- Paisja me teknologji informative dhe aparaturë tjetër për kryerjen e auditimit.

PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE.

Pas kryerjes së çdo auditimi, menaxhmentit i dorëzohet një Raport final për auditimin e kryer ku janë dhënë edhe rekomandimet tona për adresim të qëshijeve në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kontrollave të brendshme tanimë të vendosura nga ana e menaxhmentit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm përdorë metodën e mostrimit për të arritur deri te konstatimet sa më të sakta. Gjatë mostrimit aplikohet metoda e cila është më e përshtatshme për të siguruar një gjithpërlshirje si në kohë, ashtu edhe në aktivitetet në mënyrë që të jemi sa më reprezentativ në konstatimet tona. Në raportet tona kemi dhënë informata të mjaftueshme në lidhje me popullacionin ekzistues, numrin e mostrave të ekzaminuara, gjendjen e konstatuar, ndikimin e mundshëm negativ, si dhe jemi përpjekur që të analizojmë edhe shkaqet. Rekomandimet tona kanë qenë të orientuara në drejtim të eliminimit të shkaqeve që kanë qarë deri te të gjeturat e caktuara. Kujdes i veçantë i është kushtuar formulimit të rekomandimeve në mënyrë që ato të jenë të bazuara në Ligj, lehtë të kuptueshme nga ana e menaxherëve dhe mos të jenë të kushtueshme nga ana financiare.

Pas çdo finalizimi të raportit të auditimit, menaxhmentit i është dërguar edhe Modeli Planit i veprimit për adresimin e rekomandimeve ku në një afat prej 15 ditëve menaxherët kanë plotësuar këtë formularë duke shënuar në kolonat përkatëse të formularit aktivitetet që do të ndërmarrin për adresimin e rekomandimeve, personat përgjegjës për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe afatin në të cilin do të mund të kryeshin këto aktivitete në mënyrë që të bëhet implementimi i rekomandimeve.

Gjatë vitit 2024 të gjithë menaxherët të cilët kanë qenë objekt i auditimit, kanë plotësuar Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve dhe kanë dorëzuar në Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm pas pranimit të këtij Planit të veprimit, ka përpiluar orarin e vizitave për verifikimin e shkallës së adresimit të rekomandimeve. Në lidhje me këtë, Njësia e Auditimit të Brendshëm dy here brenda vitit ka raportuar mbi gjendjen e rekomandimeve të dhëna duke i klasifikuar ato si: të implementuara, në proces të implementimit, apo të pa implementuara ende.

Gjatë vitit 2024 nga shtatë raporte të finalizuara janë dhënë gjithësej 58 rekomandime nga ana jonë. Sipas Raportit të verifikimit të implementimit të rekomandimeve të kryer në fund të vitit 2024, ka rezultuar se menaxhmenti ka implementuar plotësisht 26 rekomandime apo 45%, 27 rekomandime apo 47% janë në proces të implementimit, pra janë implementuar pjesërisht, si dhe 5 apo 8% prej tyre ishin të pa implementuara ende. Rekomandimet e pa implementuara ishin të gjitha të dhëna në Raportin e fundit të auditimit i cili ishte finalizuar në fund të vitit kalendarik dhe se nuk kishte një kohë të mjaftueshme për ndërmarrjen e aktiviteteve për implementimin e tyre dhe nuk kishte një periudhë krahasuese.

Përndryshe, të gjitha rekomandimet e dhëna gjatë këtij viti ishin të pranueshme nga ana e menaxhmentit dhe për to ishte hartuar edhe Planit i veprimit për jetësimin e tyre.

Gjatë vitit ishin vërejtur edhe rezultatet konkrete nga implementimi i rekomandimeve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të financave publike. Menaxhmenti ka qenë i përkushtuar gjatë gjithë vitit për implementimin e rekomandimeve tona dhe është vërejtur aktivitetet e shtuar për implementimin e rekomandimeve.

Në të gjitha fushat e rekomanduara janë zhvilluar aktivitetet e parapara për zbatimin e rekomandimeve dhe me verifikimin e fundvitit, ne kemi identifikuar 61 aktivitete të menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve të cilat janë të evidentuara në mënyrën individuale në raportet që janë dorëzuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Në fushen e auditimit të menaxhimit me kontratat publike janë dhënë tetë rekomandime. Në lidhje me implementimin e këtyre rekomandimeve, menaxhmenti ka ndërmarrur nëntë aktivitete dhe ka arritur që të implementoj plotësisht shtatë rekomandime dhe pjesërisht një rekomandim.

Në fushen e auditimit të pasurive jofinanciare të komunës, janë dhënë nëntë rekomandime.

Menaxhmenti ka ndërmarrur dymbëdhjetë aktivitete dhe ka arritur që të implementoj plotësisht katër dhe pjesërisht pesë rekomandime.

Në fushen e auditimit të menaxhimit me resurset humane në sektorin e Administratës së Përgjithshme Komunale janë dhënë gjithësej tetë rekomandime. Menaxhmenti ka ndërmarrur njëmbëdhjetë aktivitete dhe ka arritur që të implementoj plotësisht pesë rekomandime dhe pjesërisht tri rekomandime.

Në fushen e auditimit për rishiqimin e proqesit të inkasimit të të hyrave vetanake nga Tatimi në Pronen e Paluajtshme janë dhënë gjithësej nëntë rekomandime. Menaxherët kanë ndërmarrur nëntë aktivitete dhe kanë arritur që të implementojnë plotësisht dy rekomandime, dhe pjesërisht gjashtë rekomandime.

Në fushen e inkasimit të të hyrave vetanake nga Taksat në biznes janë dhënë shtatë rekomandime, menaxhmenti ka ndërmarrur shtatë aktivitete dhe ka implementuar plotësisht tri rekomandime dhe pjesërisht katër rekomandime.

Në fushen e auditimit të proqeseve të shpenzimit të buxhetit janë dhënë gjithësej 6 rekomandime.

Menaxherët në këtë fushë kanë ndërmarrur gjithësej gjashtë aktivitete dhe kanë arritur të implementojnë plotësisht tri rekomandime dhe pjesërisht një rekomandim.

Në fushën e audituar të proqeseve të prokurimit janë dhënë njëmbëdhjetë rekomandime. Menaxhmenti ka ndërmarrur nëntë aktivitete dhe ka implementuar plotësisht dy rekomandime, dhe pjesërisht shtatë rekomandime.

Rekomandimet e implementuara pjesërisht (në proqes të implementimit), si dhe ato të pa implementuara ende, mbeten në databazën e Njesisë së Auditimit për përcjellje gjatë vitit 2025 sipas orarit të përcaktuar me Planin e veprimit për implementimin e tyre të paraqitur nga menaxhmenti pronar i këtyre rekomandimeve.

Në falenderojmë menaxhmentin për aktivitetet e zhvilluara në funksion të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe gjithashtu inkurajojmë menaxherët që ende nuk kanë arritur përbushjen e plotë të rekomandimeve tona që të angazhohen edhe më tutje për implementimin e plotë të të gjitha rekomandimeve.

Drenas, 10.02.2025



Njësia e Auditimit të Brendshëm :

Kamer Ramaj